

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues gjyqtari Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsen Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve: A. Rr. nga fshati S. i U. Komuna e Vushtrisë, V. H.1 nga fshati R. Komuna e Prizrenit, V. H.2 nga fshati R. Komuna e Prizrenit, H. H. nga P., S. H. nga Prizreni, V. J. nga fshati S. Komuna e Suharekës, B. B. nga Prizreni, M. P. nga fshati G. Komuna e Vushtrisë, I. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, A. I. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, V. H.3 nga fshati R. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kontrabandim me migrantë në bashkëkryerje nga neni 170 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KP-së, të akuzuarit V. H.3, V. H.1 dhe M. P. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së PSRK Prishtinë PPS.nr.142/2014 të datës 19. Nëntor 2015, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, duke vendosur mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë të parashtruar nga Prokuroria Themelore në Prizren PP/I nr.294/14 të datës 30.03.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av.V. K., Av. G. Gj., Av. R. T., av. N. M., Av.H. C., Av.B. S., av.E. Sh. M., av.A. K., Av.N. B., Av. N. E., Av.A. H., Av.S. M., Av.G. K. dhe Av.R. K., me datë 26.04.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.A. R., nga i ati H. dhe e ëma H., e lindur A., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin S. i U. Komuna e Vushtrisë, tani me banim në P. Rr.... pn, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.V. H.1, nga i ati R. dhe e ëma N. e lindur S., i lindur me *data e lindjes...* nga fshati R. Komuna e Prizrenit, i martuar-baba i një fëmiju, ka të kryer shkollën filllore, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3.V. H.2, nga i ati Y. dhe e ëma H., e lindur B., i lindur *data e lindjes...*, nga fshati R. Komuna e Prizrenit, i martuar, babë i një fëmiju, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4.H. H. nga i ati H. e ëma F., e lindur H., i lindur me *data e lindjes...* nga Podujeva RR.... pn, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

5.S. H., nga i ati S. dhe e ëma S., e vajzërisë H., i lindur me *data e lindjes...*, nga Prizreni Lagja ... Rr.... pn, i martuar babë i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

6.V. J., nga i ati M., dhe ëma H., e lindur V., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin S. Komuna e Suharekës ku edhe tani jeton, i martuar babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën filllore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

7.B. B. nga i ati S. dhe e ëma H., e lindur Sh., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton në RR, ... nr..., i martuar babë i 2 fëmijëve, punon si taksist, ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

8.M. P., nga i ati R., dhe e ëma M., e lindur P., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prishtinë tani me banim në fshatin G. Komuna e Vushtrisë, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i martuar babë i një fëmiju, i gjendjes së dobët ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

9.I. H., nga i ati H. dhe e ëma Q. e vajzërisë A., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin R. ku edhe tani jeton, i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, punon si taksist, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

10.A. I., nga i ati R., e ëma Gj. e vajzërisë H., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin R. ku edhe tani jeton, jeton në S., i martuar babë i dy fëmijëve, punon në ndërtimtari, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

11.V. H.3, nga i ati R. dhe e ëma Z., e lindur B., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin R. Komuna e Prizrenit ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin juridik, ppunon në ndërtimtari, i gjendjes së dobët ekonomike, shiqptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

I.Të akuzuarit A. Rr., V. H.1, V. H.2, S. H., H. H., V. J., B. B., I. H., A. I., V. H.3, M. P..

-Kanë vepruar në bashkëryerje edhe me te pandehurit J. A., E. M. dhe A. H., të cilët gjenden në arrati, si dhe me disa persona të tjerë ende të pidentifikuar, me qëllim të përfitimit të drejtëpërdrejtë dobis financiare nga hyrja e paligjështetë e shtetatsve të Kosovës në shtetet në të cilat të njejtit nuk janë banor të përhershëm i kanë rekrutuar dhe transoportuar personat e interesuar për migrim, ashtu që së paku gjatë vitit 2014, ju kanë mundësuar shumë migrantëve që të kalojnë kufinjët shtetëror dhe të hyjnë në shtete të ndyshme të Unionit European pa i përfillur kushtet e domësdoshme ligjore për hyrje në ato shtete, me çmim të caktuar, e që për person, ishte nga 1800€ deri në Wien të Austris e deri në 3500€ për shtete më të largëta të Evropës , ndërsa kontrabandimi është realizuar në atë mënyrë që para nisjes mingrantet kanë paguar 200 € për shpenzimet e rrugës, ndërsa pjesa tjetër e të hollave mbetej në Kosovë tek ndonjë person i besuar për të dyja palët dhe është paguar pas arritjes së migrantit në destinacion,, kurse nisja ka qenë kryesisht me autobus nga Prizreni ose Podujeva në drejtim të Sërbisë, me përcjellje nga ana e një apo dy të pandehurve, ose njerëzve të angazhuar nga ana e tyre, migrantet pastaj në Suboticë kanë pritur një kohë, në motele të vogla, deri sa janë krijuar kushtet që të vazhdojnë, e pastaj kufirin Serbi-Hungari e kanë kaluar ilegalisht, në këmbë, ndërsa nga qyteti Szeged në Hungari, i cili gjendet rreth 15 km nga kufiri, vazhdonin rrugën me automjete deri në destinacione të dëshiruara, kështu që në mënyrë të lartëcekur:

-Gjatë muajit Janar 2014 nga Kosova me autobus ka filluar kontrabandimi i migrantit A. K. për të cilin kontakt personi ka qenë V. H.2, i cili edhe e ka përcjellurmigrantin deri në Suboticë, por në Hungari është arrestuar.

-Me datë 20 shkurt 2014 nga Kosova me autobusin NTT “Erhan Trans” me targa *numri i targës...* ka filluar kontrabandimi i migrantit H. A. për të cilin kontakt person ka qenë F. H., pastaj F. D. i cili me këtë rast nuk ka arritur në Zvicër, ku ka dëshiruar të shkoj, ashtu që përsëri është kontrabanduar

me datë 01.qershor 2014 dhe A. H., i cili është depërtuar nga Hungaria me datë 10.prill dhe përsëri është kontrabanduar së pari me datë 17 prill dhe përfundimisht me datë 20.prill 2014 nga Kosova ka dalur në mënyrë të njejtë dhe është kontrabanduar në Zvicërr, e për të cilët kontakt personi ka qenë V. H.3.

-Kah mesi i muajit Prill 2014-është përgaditur kontrabandimi i migrantit I. S., për të cilin kontakt personi ka qenë F. H., por ky kontrabandim nuk është realizuar.

-Me datë 27 maj 2014 ka filluar kontrabandimi i migrantit G. G. (i cili pastaj është kthyer në Kosovë me datë 29.05.2014 dhe përsëri është kontrabanduar me datë 22. Qershor) dhe L. J. nga Gjakova, të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*, e për të cilët kontakt personat kanë qenë të pandehurit S. H., V. H.3 dhe A. H.,

-Me datë 11 Qershor 2014-S. K., M. C. dhe B. C. të cilët kanë kontaktuar me të pandehurit S. H., V. H.2 dhe V. H.3, ashtu që të gjithë nga Kosova kanë dalur me autobusin e cekur më lartë,

-Me datë 14 Qershor 2014 –E. A., U. B. dhe A. P. për të cilët kontakt personi ka qenë i pandehuri I. H., ashtu që nga Kosova kanë dal me autobusin e cekur më lartë.

-Me datë 15 Qershor 2015-S. Xh. për të cilin kontakt personat kanë qenë S. H. dhe V. H., ndërsa nga Kosova ka dalur me autobusin e cekur më lartë.

-Me datë 22 Qershor 2015 – Z. D., O. P., S. B., G. G., B. A. dhe N. G., për të ic lët kontakt personat kanë qenë V. H.2, S. H. dhe V. H.3, ashtu që nga Kosova kanë dalur me autobusin e cekur më lartë.

- Me datë 02. Korrik 2014 – N. S. dhe një person ende i paidentifikuar, për të cilët kontakt personi ka qenë V. H.2, të cilët kufirin në pikën kufitare Merdare kanë kaluar në këmbë.

-Me datë 13.Korrik 2014- D. E. dhe D. K., për të cilët kontakt person ka qen A.I., pastaj A. K., A. K., M. M. të cilët kanë kontaktuar me të pandehurin A. Rr., si dhe S. F., M. S., D. K. dhe U. S., ku të gjithë nga ksoova kanë dalur me autobusin “Erhan trans” me targa *numri i targës...*

-Me datë 19 Korrik 2014- D. A., H. M., për të cilët kontakt person ka qenë E. Rr., të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, të cilët pastaj janë arrestuar në Francë, me të pandehurin J. A. dhe me dy migrantë - F. B. dhe A. G., të cilët nga Kosova kanë dalur 4 ditë me herët- me datë 15 korrik 2014 në mënyrë të njejtë.

-Me datë 31 Korrik 2014 –M. B. dhe R. B. dhe me 6 migrantë ztjerë të paidentifikuar, për të cilët kontakt persona kanë qenë E. Rr., A. Rr. dhe V. H.2 ndërsa dy të parët nga Kosova kanë dalur me veturën “Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P..

-Me datë 10.Gusht 2014- - 8 mingrantë ende të paidentifikuar për të cilët kontakt persona kanë qenë A. Rr. dhe V. H.2.

-Me datë 11 Gusht 2014-6 migrantë të paidentifikuar, për të cilët kontakt persona kanë qenë të pandehurit V. J. dhe B. B., të cilët edhe i kanë përcjellur migrantët në autobusin e Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*

-Me datë 17 Gusht 2014- D. K. dhe Q. D. me dy fëmijët e saj-A. dhe K., të cilët nga Kosova kanë dalur me të pandehurin V. H.2 në veturën me targa *numri i targës...*, me vozitësin-shtetasin e Serbisë Sh. A., kurse migrantin D. K. i pandehuri i njejtë e ka vendosur në veturën me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur B. M. A. (alias B. V., i kërkuar nga autoritetet Zvicrane për veprën e njejtë), ashtu që të gjithë nga Kosova kanë dalur në të njejtën kohë-rreth 22:45 përmes pikës kufitare Dheu i Bardhë.

-Me datë 19.Gusht 2014 – 4 migrant të paidentifikuar për të cilët kontakt personi ka qenë i pandehuri V. H.1, i cili edhe i ka përcjellur migrantët në autobusin e Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*, ndërsa ate të njejtën ditë migranti D. M. nga Kosova ka dalur përmes pikës kufitare Merdare në veturën “Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P..

- Me datë 20 Gusht 2014-4 migrant të paidentifikuar për të cilët kontakt personat kanë qenë të pandehurit E. Rr. dhe A. Rr., ndërsa pikën kufitare në veri të Kosovës e kanë kaluar në veturën

“Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P., i cili ate ditë ka qenë edhe i dënuar për kundërvajtje në trafik.

-Me datë 24 Gusht 2014- M. D., F. S. dhe dy persona tjerë të paidentifikuar për të cilët kontakt personat kanë qenë E. rr., A. I. dhe A. Rr., dhe të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*

-Me datë 29 Gusht 2014 – F. A., D. S. dhe 2 persona tjerë të paidentifikuar, të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës ...*, të përcjellur nga të pandehurit B. B. dhe V. J..

-Me datë 31.Gusht 2014 –U. S., Sh. B., E. P., S. Z. dhe L. Zh. të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, e për të cilët kontakt personat kanë qenë V. H.2, E. rr., V. H.1 dhe A. I., të cilët pastaj kanë qenë të arrestuar në Hungari me të pandehurin J. A..

-Me datë 06.Shtator 2014-F. L., B. B., B. H., N. I. dhe A. K., të cilëng nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Fjolla Impex” me targa *numri i targës...* të përcjellur nga të pandehurit V. J. dhe B. B..

-Me dtë 14. Shtator 2014 –K. Rr., N. B. dhe Q. M., të cilët kufirin në pikën kufitare Merdare e kanë kaluar në këmbë me të pandehurin L. G., e për të cilët kontakt pesrona kanë qenë V. H.2 dhe A. Rr..

-Me datë 20 Shtator 2014 – V. B., B. S., B. R. dhe Sh. M. të cilët nga Kosova janë nisur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, të përcjellur nga i pandehuri V. H.1, ndërsa kontakt personi ka qenë A. H., por atë ditë kjo vepër ka mbetë në tentativë, pasi që i pandehuri V.1 është arrestuar nga ana e policisë së Kosovës, kurse migrantët janë larguar nga autobusi.

-Me datë 21. Shtator 2015 – dy migrantë të paidentifikuar të cilët kanë filluar të kontrabandohen ashtu që nga Kosova kanë tentuar të dalin me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” ashtu që nga Kosova kanë tentuar të dalin me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, e për të cilët kontakt personat kanë qenë L. G. dhe A. Rr..

-Me datë 22. Shtator 2015 –K. M., Sh. Gj., Xh. G., R. K. dhe D. K. me 4 fëmijët, për të cilët kontakt personat kanë qenë të pandehurit A. I. dhe V. H.2, të cilët kanë qëndruar në Suboticë deri me datën 27. Shtator kur të pandehurit e kanë organizuar kthimin e tyre në Kosovë me 2 vetura kombi me targa të Hungarisë *numri i targës...*, për t i kontrabandaur përsëri, vetëm disa ditë më vonë dhe atë Xh. G. dhe Sh. Xh. me datë 01. Tetor 2014, kurse R. K. me bashkshorten D. K. dhe me dt.02 Tetor 2014.

-Me datë 03.Tetor 2014 – K. K., për të cilin kontakt personat kanë qenë V. H.2 dhe A. Rr..

-Me datë 10.Tetor 2014- H. H., E. J., F. M. dhe J. H., për të cilët kontakt person ka qnë i pandehuri S. H., dhe të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*, të përcjellur nga pesoni i quajtur A. C., i angazhuar për këtë nga i pandehuri S. H..

-Me datë 11. Tetor 2014 – H. K., për të cilin kontakt personi ka qenë i pandehuri H. H., dhe i cili nga Kosova ka dalur me autobusi të Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*

-Me datë 13.Tetor 2014 – F. S. me tre fëmijët e saj dhe M. M., të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Audio Tours” me targa *numri i targës...*, për të cilin kontakt person ka qenë i pandehuri H. H..

-Me datë 18.Tetor 2014 – V. M., N. H., Sh. M. dhe K. S. të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Audio Tours” me targa *numri i targës* të përcjellur nga i pandehuri V. J. dhe personi i lartpërmendur A. C., e ë cilët pastaj janë arrestuar në Zvicër.

Me datë 25 Tetor 2014 –G. L., M. K., Sh. M. dhe 3 migrantë tjerë të paidentifikuar, ashtu që të tre migrantë të lartë cekur kufirin e Kosovës në pikën kufitare Merdare kanë kaluar në këmbë, të përcjellur nga i pandehuri H. H., kurse të tjerët në autobus në të cilin pas kalimit të kufirit kanë hypur të gjithë.

-Me këtë të pandehurit e lartëcekur në bashkëkryerje kanë kryer veprën enale Kontrabandimi me migrantë ng neni 170 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK.

II. Të akuzuarit V. H.3, V. H.1 dhe M. P..

Në shtëpijtë e tyre kanë mbajtur në pronësi dhe posedim, armë ose pjesë të armës, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për armët NR. 03/L-143 dhe ate: I pandehuri V. H.3, në shtëpinë e tij në fshatin R., Komuna e Prizrenit, ka mbajtur një pushkë gjysëmautomatike me nr.serik 3226574, i pandehuri V. H.1 në shtëpinë e tij në të njejtin fshat – R., ka mbajturnjë dylbi të armës zjarri, pa numër serik, ndërsa i pandehuri M. P. në shtëpinë e tij në fshatin G., Komuna e Vushtrisë ka mbajtur një armë të gjatë AK 47 me nr.serik 3106, tre karikator të armës së lartëcekur, 20 fishek të armës të gjuetisë së kalibrit 16 mm, 25 fishekë të armës së gjuetisë së kalibrit 20 mm, 61 fishek të armës AK 47 të kalibrit 7.62 të cilat janë gjetur me rastin e kontrollit nga ana e policisë me datë 05 Nëntor 2014, në adresat e lartëcekura.

-Me këtë, secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitivit të lartshënuar 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 nenit 170 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KP-së si dhe nenit 374 par.1 të KP-së, të akuzuarit i

GJYKON

1. Të akuzuarin A. R. me denim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 muaj e 19 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.03.2015 deri me datën 14.08.2015.

2. Të akuzuarin V. H.1 me denim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 10 muaj e 17 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.09.2014 deri me datën 07.08.2015.

Për veprën penale nga neni 374 paragrafi 1 i KPK i shqiptohet denimi me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind)euro,

Në kuptim të nenit 80 të KP-së të akuzuarit V. H.1 i shqiptohet

DËNIMI UNIK

Me gjobë në lartësi prej 5000 (pesëmijë) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje

prej 10 muaj e 17 ditë, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 21.09.2014 deri me datën 07.08.2015.

3. Të akuzuarin V. H.2 me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me dënim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 06.08.2015.

4. Të akuzuarin H. H. me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me dënim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 muaj e 2 ditë, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.05.2015 deri me datën 17.06.2015.

5. Të akuzuarin S. H. me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me dënim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 2 ditën në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 07.08.2015.

6. Të akuzuarin V. J. me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me dënim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 2 ditë, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 07.08.2015.

7. Të akuzuarin B. B. me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me dënim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 19 ditë, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 25.08.2015.

8. Të akuzuarin M. P. me dënim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 06.08.2015.

Për veprën penale nga neni 374 paragrafi 1 i KPK i shqiptohet denimi me gjobë në lartësi prej 1000 (njëmijë) euro,

Në kuptim të nenit 80 të KP-së të akuzuarit M. P. i shqiptohet:

DËNIMI UNIK

Me gjobë në lartësi prej 6.500 (gjashtëmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 06.08.2015.

9. Të akuzuarin I. H., me denim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 2 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 07.08.2015.

10. Të akuzuarin A. I. me denim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 muaj e 3 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 03.03.2015 deri me datën 06.08.2015.

11 Të akuzuarin V. H.3 me denim me gjobë në lartësi prej 4.500 (katërmijë e pesëqind) euro, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 2 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 07.08.2015.

Për veprën penale nga neni 374 paragrafi 1 i KPK i shqiptohet denimi me gjobë në lartësi prej 700 (shtatëqind) euro,

Në kuptim të nenit 80 të KP-së të akuzuarit V. H. i shqiptohet:

DËNIMI UNIK

Me gjobë në lartësi prej 5.200 (pesëmijë e dyqind) euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit. Në se i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën atëherë denimi me gjobë do ti zëvendsohet me denim me burgim në ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, si dhe denimi me burgim në kohëzgjatje prej 9 muaj e 2 ditë, në të cilin denim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 05.11.2014 deri me datën 07.08.2015.

Në kuptim të nenit 374 paragrafi 3 ndaj të akuzuarit V. H.3 konfiskohet një pushkë gjysmë automatike me numër serik 3226574, të akuzuarit V. H.1 i konfiskohen një palë dylbi të armës së zjarrit pa numër serik, të akuzuarit M. P. i konfiskohen një armë e gjatë AK 47 me numër serik 3106, tre karikator kësaj arme, 20 fishekë të armës së gjuetisë të kalibrit 16 mm, 25 fishekë të armës së gjuetisë të kalibrit 20 mm, 61 fishekë të armës AK 47 të kalibrit 7.62 mm.

Në pajtim me nenin 170 paragrafi 10 pika 10.5 të Kodit Penal të akuzuarve konfiskohen telefonat mobil si pajisje e përdorur për kryerjen e veprës penale.

Obligohen të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës në lartësi prej secili nga 100 (njëqind) euro, krejt këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PPS.nr.142/2014 të datës 19. Nëntor 2015, kundër të akuzuarve A. Rr. nga fshati S. i U. Komuna e Vushtrisë, V. H.1 nga fshati R. Komuna e Prizrenit, V. H.2 nga fshati R. Komuna e Prizrenit, H. H. nga Podujeva, A. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, F. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, S. H. nga Prizreni, E. R. nga fshati S. i P. Komuna e Vushtrisë, V. J. nga fshati S. Komuna e Suharekës, B. B. nga Prizreni, M. P. nga fshati G. Komuna e Vushtrisë, I. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, A. I. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, V. H.3 nga fshati R. Komuna e Prizrenit dhe L. G. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale dhe atë: të akuzuarit A. R., V. H.1, V. H.2, S. H., H. H., E. Rr., V. J., B. B., I. H., A. I., V. H.3, M. P., A. H., F. H. dhe L. G., për veprën penale kontrabandim me migrantë nga neni 170 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, ndërsa të akuzuarit V. H.3, V. H.2 dhe M. P. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-së.

Kjo gjykatë me aktvendimin Pkr.nr.210/15 të datës 27.12.2017 ka veçuar procedurën penale ndaj të akuzuarit L. G. për shkak se i njejtë ka qenë i paarritshëm për gjykatën. Po ashtu kjo gjykatë me aktvendimin Pkr.nr.210/15 të datës 27.04.2018 ka veçuar procedurën penale ndaj të akuzuarve F. H., A. H. dhe E. R., për shkak se të njejtë nuk e kanë nënshkruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë e kjo për arsye të ekonomizimit të procedurës dhe ka vazhduar procedurën me të akuzuarit tjerë.

Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor Prokuroria Themelore në Prizren me datë 26.04.2018 ka parashtruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë PP/I nr.294/14 të datës 30.03.2018.

Gjykata në pajtim me nenin 247 të KPP-së gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi pranë marrëveshjes së arritur, duke shtuar se të akuzuarve ka shpjeguar në tërësi qëllimi e arritjes së marrëveshjes si dhe sanksionin të cilin prokuroria e ka propozuar në këtë marrëveshje. Gjithashtu kanë qenë prezent edhe avokatët mbrojtës të akuzuarve të cilët nuk kanë pasur kundërshtime dhe e kanë mbështetur marrëveshjen e arritur. Ka propozuar gjykatës që kjo marrëveshje e aprovuar dhe e nënshkruar nga të akuzuarit, avokatët mbrojtës dhe prokurorisë të aprovohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. Rr. avokati V. K. e ka mbështetur në tërësi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, duke konsideruar se i mbrojturi i tij e ka kuptuar plotësisht natyrën e pranimit të marrëveshjes, ka propozuar që e njëjta të aprovohet, ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. H.1 avokati G. Gj. ka deklaruar se e mbështet në tërësi marrëveshjen për pranimin e fajësisë me ato kushte që janë propozuar në prokurori duke kërkuar nga gjykata që ta aprovojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. H.2 avokti R. T. ka propozuar gjykatës që të aprovojë marrëveshjen në tërësi ndërsa lidhur me dënimin ka deklaruar se ka dërguar raportin e mjekut lidhur me sëmundjen e të akuzuarit V.2 prandaj ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. H. av.N. M. ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrveshjes së nënshkruar në Prokurorinë themelore në Prizren me datë 30.03.2018 duke propozuar gjykatës që të njejtën ta aprovojë si të bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. J. avokati N. B. ka propozuar që marrëveshja të aprovohet në tërësi, dhe pas aprovimit të kësaj marrveshje ka propozuar që të vendoset për masën e dorëzarisë ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. B. avokati N. E. deklaroi se e mbështes në tërësi vullnetin e të mbrojturit të tij për nënshkrimin e kësaj marrveshje dhe ka propozuar që të aprovohet nga ana e gjykatës ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. H. avokati S. M. në tërësi e ka mbështetur marrveshjen, duke propozuar që e njejtë të aprovohet dhe masa e dorëzarisë të tërhiqet ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje dhe mundësisht dënimi të paguhet me këste.

Mbrojtësi i të akuzuarit S. H. av. E. Sh. M. ka deklaruar se në tërësi e mbështes marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, si dhe kushtet e përfshira në te, ka propozuar që gjykata të aprovojë këtë marrëveshje ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. I. avokati G. K. ka deklaruar se e mbështetë në tërësi vullnetin e të mbrojturit të tij për nënshkrimin e marrveshjes për pranimin e fajësisë dhe ka propozuar që marrëveshja të aprovohet në tërësi ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. H.3, avokati R. K., ka deklaruar se pasi që i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë për pikat e nënshkruara në marrveshje, atëherë e mbështet dhe propozoi që e njejtë të aprovohet në tërësi, dhe të gjitha rekomandimet e përfshira në të njejtën ndërsa lidhur me dënimin ka propozuar që të shqiptohet minimumi i dënimit me gjobë i propozuar në marrëveshje, ka kërkuar që mundësisht dënimi të paguhet me këste.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. P. Avokati A. H., konsideron se janë plotësuar kushtet për pranimin e marrveshjes nga ana e gjykatës dhe njëherit meqenëse kemi të bëjmë me denim të rekomanduar e jo të përcaktuar në raport me denimin me gjobë, kërkoi nga gjykata që të përcaktohet për një denim sa më të butë, duke pas parasysh gjendjen e vështirë materiale të akuzuarit dhe me aktgjykim të përaktojë mundësinë e pagesës së dënimit me këste dhe njëherit meqenëse aktgjykimi do të merret në bazë të kësaj marrveshje do të jetë edhe aktgjykim i formës së prerë për faktin se me marrëveshje kemi hek dorë nga e drejta e ankesës, konsideroi se janë plotësuar kushtet që të merret një vendim për lirimin e dorëzarisë si masë e sigurisë në procedurë, për faktin se nga marrëveshje rezulton që i mbrojturi i tij do të denohet me aq kohë burgim sa ka mbajtur në paraburgim dhe lirimi i dorëzarisë bëhet atëher kur përfundoh edhe vuajtja e dënimit të përcaktuar me aktgjykim, gjë që kemi të bëjmë me rastin konkret.

Të gjithë të akuzuarit kanë deklaruar se paraprakisht janë konsultuar me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajësisë përkatësisht nënshkrimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar ta pranojnë fajësinë.

Gjykata nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka vërtetuar se prokurori i shtetit me rastin e arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka bërë rikualifikimin e veprës penale pra në rastin konkret marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur në mes të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre për veprën penale kontrabandim me migrant në bashkëkryerje nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP.

Nga të cekurat më lartë si dhe nën kushtet dhe rrethanat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit A. Rr., V. H.1, V. H.2, S. H., H. H., E. Rr., V. J., B. B., I. H., A. I., V. H.3, M. P., A. H., F. H. dhe L. G. kanë vepruar në bashkëkryerje si antarë të grupit kriminal, edhe me të pandehurit J. A., E. M. dhe A. H., të cilët gjenden në arrati, si dhe me disa persona të tjerë ende të paidentifikuar, me qëllim të përfitimit të drejtëpërdrejtë dobis financiare nga hyrja e paligjeshmë e shtetatsve të Kosovës në shtetet në të cilat të njëjtit nuk janë banor të përhershëm i kanë rekrutuar dhe transportuar personat e interesuar për migrim, ashtu që së paku gjatë vitit 2014, ju kanë mundësuar shumë migrantëve që të kalojnë kufinjët shtetëror dhe të hyjnë në shtete të ndryshme të Unionit Europian pa i përfillur kushtet e domësdoshme ligjore për hyrje në ato shtete, me çmim të caktuar, e që për person, ishte nga 1800€ deri në Wien të Austrisë e deri në 3500€ për shtete më të largëta të Evropës , ndërsa kontrabandimi është realizuar në atë mënyrë që para nisjes migrantet kanë paguar 200 € për shpenzimet e rrugës, ndërsa pjesa tjetër e të hollave mbetej në Kosovë tek ndonjë person i besuar për të dyja palët dhe është paguar pas arritjes së migrantit në destinacion,, kurse nisja ka qenë kryesisht me autobus nga Prizreni ose Podujeva në drejtim të Serbisë, me përcjellje nga ana e një apo dy të pandehurve, ose njerëzve të angazhuar nga ana e tyre, migrantet pastaj në Suboticë kanë pritur një kohë, në motele të vogla, deri sa janë krijuar kushtet që të vazhdojnë, e pastaj kufirin Serbi-Hungari e kanë kaluar ilegalisht, në këmbë, ndërsa nga qyteti Szeged në Hungari, i cili gjendet rreth 15 km nga kufiri, vazhdonin rrugën me automjete deri në destinacione të dëshiruara, kështu që në mënyrë të lartëcekur:

-Gjatë muajit Janar 2014 nga Kosova me autobus ka filluar kontrabandimi i migrantit A. K. për të cilin kontakt personi ka qenë V. H.2, i cili edhe e ka përcjellur migrantin deri në Suboticë, por në Hungari është arrestuar.

-Me datë 20 shkurt 2014 nga Kosova me autobusin NTT "Erhan Trans" me targa *numri i targës..* ka filluar kontrabandimi i migrantit H. A. për të cilin kontakt person ka qenë F. H., pastaj F. D. i cili me këtë rast nuk ka arritur në Zvicër, ku ka dëshiruar të shkoj, ashtu që përsëri është kontrabanduar me datë 01.qershor 2014 dhe A. H., i cili është depërtuar nga Hungaria me datë 10.prill dhe përsëri është kontrabanduar së pari me datë 17 prill dhe përfundimisht me datë 20.prill 2014 nga Kosova ka dalur në mënyrë të njëjtë dhe është kontrabanduar në Zvicër, e për të cilët kontakt personi ka qenë V. H..

-Kah mesi i muajit Prill 2014-është përgaditur kontrabandimi i migrantit I. S., për të cilin kontakt personi ka qenë F. H., por ky kontrabandim nuk është realizuar.

-Me datë 27 maj 2014 ka filluar kontrabandimi i migrantit G. G. (i cili pastaj është kthyer në Kosovë me datë 29.05.2014 dhe përsëri është kontrabanduar me datë 22. Qershor) dhe L. J. nga Gjakova, të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë "Sharri" me targa *numri i targës ...*, e për të cilët kontakt personat kanë qenë të pandehurit S. H., V. H.3 dhe A. H.,

-Me datë 11 Qershor 2014-S. K., M. C. dhe B. C. të cilët kanë kontaktuar me të pandehurit S. H., V. H.2 dhe V. H.3, ashtu që të gjithë nga Kosova kanë dalur me autobusin e cekur më lartë,

-Me datë 14 Qershor 2014 –E. A., U. B. dhe A. P. për të cilët kontakt personi ka qenë i pandehuri I. H., ashtu që nga Kosova kanë dal me autobusin e cekur më lartë.

-Me datë 15 Qershor 2015-S. Xh. për të cilin kontakt personat kanë qenë S. H. dhe V. H.2, ndërsa nga Kosova ka dalur me autobusin e cekur më lartë.

-Me datë 22 Qershor 2015 – Z. D., O. P., S. B., G. G., B. A. dhe N. G., për të ic lët kontakt personat kanë qenë V. H.2, S. H. dhe V. H.3, ashtu që nga Kosova kanë dalur me autobusin e cekur më lartë.

-Me datë 02. Korrik 2014 – N. S. dhe një person ende i paidentifikuar, për të cilët kontakt personi ka qenë V. H.2, të cilët kufirin në pikën kufitare Merdare kanë kaluar në këmbë.

-Me datë 13.Korrik 2014- D. E. dhe D. K., për të cilët kontakt person ka qen A. I., pastaj A. K., A. K., M. M. të cilët kanë kontaktuar me të pandehurin A. Rr., si dhe S. F., M. S., D. K. dhe U. S.j, ku të gjithë nga Kosova kanë dalur me autobusin “Erhan trans” me targa *numri i targës...*

-Me datë 19 Korrik 2014- D. A., H. M., për të cilët kontakt person ka qenë E. Rr., të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin “Erhan Trans” me targa *numri i targës ..*, të cilët pastaj janë arrestuar në Francë, me të pandehurin J. A. dhe me dy migrantë - F. B. dhe A. G., të cilët nga Kosova kanë dalur 4 ditë me herët- me datë 15 korrik 2014 në mënyrë të njëjt.

-Me datë 31 Korrik 2014 –M. B. dhe R. B. dhe me 6 migrantë ztjerë të paidentifikuar, për të cilët kontakt persona kanë qenë E. Rr., A. Rr. dhe V. H.2 ndërsa dy të parët nga Kosova kanë dalur me veturën “Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P..

- Me datë 10.Gusht 2014- - 8 migrantë ende të paidentifikuar për të cilët kontakt persona kanë qenë A. Rr. dhe V. H.2.

Me datë 11 Gusht 2014-6 migrantë të paidentifikuar, për të cilët kontakt persona kanë qenë të pandehurit V. J. dhe B. B., të cilët edhe i kanë përcjellur migrantët në autobusin e Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*

-Me datë 17 Gusht 2014- D. K. dhe Q. D. me dy fëmijët e saj-A. dhe K., të cilët nga Kosova kanë dalur me të pandehurin V. H.2 në veturën me targa *numri i targës...*, me vozitësin-shtetasin e Serbisë Sh. A., kurse migrantin D. K. i pandehuri i njëjtë e ka vendosur në veturën me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur B. M. A. (alias B. V., i kërkuar nga autoritetet Zvicrane për veprën e njëjtë), ashtu që të gjithë nga Kosova kanë dalur në të njëjtën kohë-rreth 22:45 përmes pikës kufitare Dheu i Bardhë.

-Me datë 19.Gusht 2014 – 4 migrant të paidentifikuar për të cilët kontakt personi ka qenë i pandehuri V. H.1, i cili edhe i ka përcjellur migrantët në autobusin e Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...*, ndërsa ate të njëjtën ditë migranti D. M. nga Kosova ka dalur përmes pikës kufitare Merdare në veturën “Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P.

- Me datë 20 Gusht 2014-4 migrant të paidentifikuar për të cilët kontakt personat kanë qenë të pandehurit E. Rr. dhe A. Rr., ndërsa pikën kufitare në veri të Kosovës e kanë kaluar në veturën “Mercedes Benz” me targa *numri i targës...* të cilën e ka vozitur i pandehuri M. P., i cili ate ditë ka qenë edhe i dënuar për kundërvajtje në trafik.

-Me datë 24 Gusht 2014- M. D., F. S. dhe dy persona tjerë të paidentifikuar për të cilët kontakt personat kanë qenë E. rr., A. I. dhe A. Rr., dhe të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës....*

-Me datë 29 Gusht 2014 – F. A., D. S. dhe 2 persona tjerë të paidentifikuar, të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës..*, të përcjellur nga të pandehurit B. B. dhe V. J..

-Me datë 31.Gusht 2014 –U. S., Sh. B., E. P., S. Z. dhe L. Zh. të cilët nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, e për të cilët kontakt personat kanë

qenë V. H.2, E. rr., V. H.1 dhe A. I., të cilët pastaj kanë qenë të arrestuar në Hungari me të pandehurin J. A..

-Me datë 06.Shtator 2014-F. L., B. B., B. H., N. I. dhe A. K., të cilëng nga Kosova kanë dalur me autobusin e Kompanisë “Fjolla Impex” me targa *numri i targës...* të përcjellur nga të pandehurit V. J.dhe B. B..

-Me dtë 14. Shtator 2014 –K. Rr., N. B. dhe Q. M., të cilët kufirin në pikën kufitare Merdare e kanë kaluar në këmbë me të pandehurin L. G., e për të cilët kontakt pesrona kanë qenë V. H.2 dhe A. Rr..

-Me datë 20 Shtator 2014 – V. B., B. S., B. R. dhe Sh. M. të cilët nga Kosova janë nisur me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*, të përcjellur nga i pandehuri V. H.1, ndërsa kontakt personi ka qenë A. H., por atë ditë kjo veper ka mbetë në tentativë, pasi që i pandehuri V.1 është arrestuar nga ana e policisë së Kosovës, kurse migrantët janë larguar nga autobusi.

-Me datë 21. Shtator 2015 – dy migrantë të pidentifikuar të cilët kanë filluar të kontrabandohen ashtu që nga Kosova kanë tentuar të dalin me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” ashtu që nga Kosova kanë tentuar të dalin me autobusin e Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...* e për të cilët kontakt pesonat kanë qenë L. G. dhe A. Rr..

-Me datë 22. Shtator 2015 –K. M., Sh. Gj., Xh. G., R. K. dhe D. K. me 4 fëmijët, për të cilët kontakt pesonat kanë qenë të pandehurit A. I. dhe V. H.2, të cilët kanë qëndruar në Suboticë deri me datën 27. Shtator kur të pandehurit e kanë organizuar kthimin e tyre në Kosovë me 2 vetura kombi me targa të Hungarisë *numri i targës...*, për t i kontrabandaur përsëri, vetëm disa ditë më vonë dhe atë Xh. G. dhe Sh. Xh. me datë 01. Tetor 2014, kurse R. K. me bashkshorten D. K. dhe me dt.02 Tetor 2014.

-Me datë 03.Tetor 2014 – K. K., për të cilin kontakt personat kanë qenë V. H.2 dhe A. Rr..

-Me datë 10.Tetor 2014- H. H., E. J., F. M. dhe J. H., për të cilët kontakt person ka qnë i pandehuri S. H., dhe të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Sharri” me targa *numri i targës...* të përcjellur nga pesoni i quajtur A C., i angazhuar për këtë nga i pandehuri S. H..

Me datë 11. Tetor 2014 – H. K., për të cilin kontakt personi ka qenë i pandehuri H. H., dhe i cili nga Kosova ka dalur me autobusi të Kompanisë “Erhan Trans” me targa *numri i targës...*

-Me datë 13.Tetor 2014 – F. S. me tre fëmijët e saj dhe M. M., të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Audio Tours” me targa *numri i targës...*, për të cilin kontakt person ka qenë i pandehuri H. H..

-Me datë 18.Tetor 2014 – V. M., N. H., Sh. M. dhe K. S. të cilët nga Kosova kanë dalur me autobus të Kompanisë “Audio Tours” me targa *numri i targës...* të përcjellur nga i pandehuri V. J. dhe personi i lartpërmendur A. C., e ë cilët pastaj janë arrestuar në Zvicër.

-Me datë 25 Tetor 2014 –G. L., M. K., Sh. M. dhe 3 migrantë tjerë të pidentifikuar, ashtu që të tre migrantë të lartë cekur kufirin e Kosovës në pikën kufitare Merdare kanë kaluar në këmbë, të përcjellur nga i pandehuri H. H., kurse të tjerët në autobus në të cilin pas kalimit të kufirit kanë hypur të gjithë.

Në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit V. H.3, V. H.1 dhe M. P. në shtëpijtë e tyre kanë mbajtur në pronësi dhe posedim, armë ose pjesë të armës, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për armët NR. 03/L-143 dhe ate: I pandehuri V. H.3, në shtëpinë e tij në fshatin R., Komuna e Prizrenit, ka mbajtur një pushkë gjysëautomatike me nr.serik 3226574, i pandehuri V. H.1 në shtëpinë e tij në të njejtin fshat – R., ka mbajturnjë dylbi të armës zjarri, pa numër serik, ndërsa i panandehuri M. P. në shtëpinë e tij në fshatin G., Komuna e Vushtrisë ka mbajtur një armë të gjatë AK 47 me nr.serik 3106, tre karikator të armës së lartëcekur, 20 fishek të armës të gjuetisë së kalibrit 16 mm, 25 fishekë të armës së gjuetisë së kalibrit 20 mm, 61 fishek të armës AK 47 të kalibrit 7.62 të cilat janë gjetur me rastin e kontrollit nga ana e policisë me datë 05 Nëntor 2014, në adresat e lartëcekura.

Pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, si dhe të akuzuarit lidhur me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, gjykata ka konstatuar se të akuzuarit në asnjë mënyrë nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar ta pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat janë paraqitur në aktakuzë të pranuar edhe nga të akuzuarit dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat që parashihen në dispozitat e nenit 253 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës, prandaj edhe ka vendosur që ta pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Lidhur me dënimin prokurori i shtetit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ka shtuar se sa i përket dënimit me gjobë ia len në vlerësim gjykatës për vendosje për lartësinë e dënimit.

Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre lidhur me dënimin kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpalli fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve, se në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 i KP dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 450, dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Pkr.nr.210/15 datë 26.04.2018

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj

UDHËZIM JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtë ankese sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, ndërsa për bazat tjera kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.